FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

Prostacure

Kapsula të forta me çlirim të zgjatur - 0.4 mg
(Tamsulozin klorhidrat)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Çfarë përmban ky fletëudhëzues:

1. Çfarë është Prostacure dhe përse përdoret
2. Çfarë duhet të dini përpara se të përdorni Prostacure
3. Si ta përdorni Prostacure
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Prostacure
6. Përmbajtja e paketimit dhe informacione të mëtejshme

1. Çfarë është Prostacure dhe përse përdoret

Prostacure përdoret në trajtimin e simptomave funksionale të hiperplazisë beninje të prostatës, të tilla si vështirësia në urinim.
Lënda vepruese e Prostacure është tamsulozin. Tamsulozina është një bllokues i receptorëve alfa1, që redukton tensionin në muskujt e prostatës dhe uretrës. Në këtë mënyrë mundësohet një rrjedhje e lehtë e urinës përmes uretrës dhe lehtësohet urinimi.

2. Çfarë duhet të dini përpara se të merrni Prostacure

Mos merrni Prostacure
- në qoftë se jeni alergjik nga tamsulozina apo nga ndonjëri prej përbërësve të tjerë të barit (të renditur në pikën 6)
- në qoftë se vuani nga hipotensioni ortostatik
- në qoftë se vuani nga një insufiçiencë e rëndë hepatike.

Përkujdesjet gjatë përdorimit
Konsultohuni me mjekun ose farmacistin tuaj përpara se të merrni Prostacure
- në qoftë se vuani nga hipotensioni ortostatik (marrje mendsh e shkaktuar nga rënia e presionit të gjakut, kur uleni ose ngriheni në këmbë)
- në qoftë se merrni të tjerë bllokues të receptorëve alfa1
- në qoftë se vuani nga një insufiçiencë e rëndë renale.

Nëse jeni duke ju nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjikale në sy për shkak të kataraktit (turbullim i shikimit), ju lutemi të informoni mjekun tuaj specialist të syve para operacionit, që ju jeni duke përdorur ose keni përdorur më përpara Prostacure. Prostacure mund të shkaktojë komplikime gjatë operacionit, të cilat mund të menaxhohen në qoftë se specialisti juaj është i përgatitur paraprakisht.

Marrja e Prostacure me ushqim dhe pije
Prostacure duhet të merret pasi të hani mëngjesin ose pas vaktit të parë të ditës, me një gotë ujë.

Shtatzënia, ushqimi me gji dhe fertiliteti
Prostacure përdoret vetëm në pacientët meshkuj.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Nuk ka të dhëna të vlefshme nëse tamsulozina ndikon negativisht në aftësinë për të drejtuar automjetin ose për të përdorur makineri.
Megjithatë, pacientët duhet të jenë në dijeni të faktit se Prostacure mund të shkaktojë marrje mendsh.

Barnat e tjera dhe Prostacure
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj nëse jeni duke marrë / përdorur ose keni marrë / përdorur kohët e fundit ose do të merrni / përdorni ndonjë bar tjetër.
Përdorimi i njëkohshëm i tamsulozinës me të tjerë bllokues të receptorëve alfa1 (prazosinë, alfuzosinë), mund të shkaktojë hipotension.

3. Si ta përdorni Prostacure

Gjithmonë ky bar përdoret ekzaktësisht si ju thotë mjeku juaj. Këshillohuni me mjekun ose farmacistin tuaj nëse nuk jeni të sigurt.
Doza e rekomanduar është një kapsulë në ditë.
Prostacure duhet të merret pasi të hani mëngjesin ose pas vaktit të parë të ditës, me një gotë ujë.
Kapsula duhet të gëlltitet e tëra, ndërkohë që jeni ulur ose në këmbë (jo në pozicionin e shtrirë).
Kapsula nuk duhet përtypur pasi kjo do të ndërhyjë në çlirimin e modifikuar të lëndës vepruese.

Nëse keni përshtypjen se efekti i Prostacure është shumë i fortë ose shumë i dobët, konsultohuni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Në qoftë se keni marrë më shumë Prostacure sesa duhet
Në qoftë se keni marrë më shumë Prostacure sesa ju përshkruan mjeku, kontaktoni mjekun tuaj ose spitalin.

Në qoftë se keni harruar të merrni Prostacure
Në qoftë se keni harruar ta merrni barin pasi keni ngrënë mengjesin, mund ta merrni më vonë në të njëjtën ditë. Në qoftë se harroni një dozë, merreni dozën në ditën në vijim.

4. Efekte anësore të mundshme

Si të gjithë barnat e tjera, Prostacure mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Gjatë përdorimit të tamsulozinës janë raportuar efektet e mëposhtme anësore:

Të zakonshme: mund të ndikojë në më pak se 1 në 10 njerëz
Marrje mendsh, çrregullime të ejakulimit.

Të pazakonta: mund të ndikojë në më pak se 1 në 100 njerëz
Dhimbje koke, palpitacione, marrje mendsh sidomos kur ulesh poshtë ose ngrihesh në këmbë nga pozicioni i shtrirë, rinit, çrregullime gastro-intestinale (konstipacion, diarre, nauze, të vjella), reaksione alergjike (skuqje të lëkurës, prurit, urtikarie), dobësi.

Të rralla: mund të ndikojë në më pak se 1 në 1.000 njerëz
Të fikët, angioedemë.

Shumë të rralla: mund të ndikojë në më pak se 1 në 10.000 njerëz
Sindromi Stevens-Johnson, priapizëm (ereksion i vazhdueshëm dhe i dhimbshëm).

Të panjohura: Frekuenca nuk mund të vlerësohet nga të dhënat e disponueshme
Çrregullime të rrahjeve të zemrës (fibrilacion atrial, aritmi), rritje të rrahjeve të zemrës (takikardi), marrje fryme (dispne).

Nëse ju shfaqet ndonjë efekt anësor, njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj, përfshirë edhe ndonjë efekt anësor tjetër që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues.

5. Si ta ruani Prostacure

Ruajeni barin larg fëmijëve.
Ruajeni në paketimin origjinal.
Mos e ruani mbi 30°C.
Mos e përdorni barin pas datës së skadencës të shënuar në blister dhe në kuti pas "Skad".

6. Përmbajtja e paketimit dhe informacione të mëtejshme

Çfarë përmban Prostacure
- Lënda vepruese është tamsulozin klorhidrat. Çdo kapsulë me çlirim të zgjatur përmban 0.4 mg tamsulozin klorhidrat.

- Përbërësit e tjerë janë
  Përmbajtja e kapsulës: algjinat natriumi, kopolimer (1:1) acid metakrilik –etil akrilat, glicerinë dibehenat, maltodekstrinë, laurilsulfat natriumi, makrogol 6000, polisorbat 80, hidroksid natriumi, emulsion i simetikonit (simetikon, metilcelulozë, acid sorbik), dioksid silici koloidal.
  Përbërja e kapsulës: xhelatinë, oksid hekuri i kuq (E172), dioksid titani (E171), oksid hekuri i verdhë (E172).

Përmbajtja e paketimit
Prostacure disponohet në blistera, në kuti me nga 20 dhe 30 kapsula.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel. Fax: 00 355 4 23 62 800
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Gusht 2014.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.